

ARGUMENTUM

news opinion analysis



EKSKLUZIVE

Ambasadori i Turqisë, Tayyar Kagan Atay

Shqipëria dhe Turqia, aleatë strategjikë për stabilitet dhe zhvillim në Ballkan

-Lamtumirë Fatos Nano!

- Mr. Gorbachev, tear down this wall!

- Donald Trump shpall marrëveshjen e armëpushimit Izrael-Hamas

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 SPECIALE

- “Ndahet nga jeta ish-kryeministri Fatos Nano, mbyllet një epoke në Partinë Socialiste dhe politikën shqiptare”.

- Përcillet në banesën e fundit menderimet më të lartashtetërore ish-lideri i Partisë Socialiste dhe ish-kryeministri Fatos Nano

07 OP/ED

- Mr. Gorbachev, tear down this wall!

10 JO VETEM LAJMI

- Lamtumira e parakohëshme për Janusz Bugajskin, udhëprijësin e mendimit dhe vizionit të politikës ndërkombëtare.

12 FOKUS

- “Kinanuk zgjedhmes Moskës dhe Uashingtonit — zgjedhveten”.

14 INTERVISTA

- EKSKLUZIVE/Ambasadori i Turqisë, Tayyar Kagan Atay: Shqipëria dhe Turqia, aleatë strategjikë për stabilitet dhe zhvillim në Ballkan.

20 REALPOLITIK

- Armëpushim po, paqe jo! Duhet zgjidhja me dy shtete! Fundi i politikës amerikane me zik-zake? 19 Sanksione, Mur anti-dronë dhe Pavarësi ekonomike!

22 POLITIKË

- BE disburson 100 milionë euro për Shqipërinë në kuadër të

Planit të Rritjes të BE-së.

23 RAJONI

- Zgjedhjet lokale në Maqedoninë e Veriut: Kush fitoi?

24 BOTA

- Historike: Trump njofton se Izraeli dhe Hamasi kanë arritur fazën e parë të marrëveshjes së paqes në Gaza.

ENGLISH EDITION

26 IN FOCUS

- Former Prime Minister Fatos Nano passes away, closing an Era in the Socialist Party and Albanian Politics.

27 INTERVIEW

- EXCLUSIVE | Ambassador Tayyar Kagan Atay: Türkiye and Albania, a Strategic Partnership Rooted in Shared Heritage and a Common Vision for the Future.

28 OP/ED

- The Middle Corridor: Azerbaijan as a Strategic Node Between Asia and Europe.

30 REALPOLITIK

- Ceasefire but no peace!

Ceasefire but no peace! The two-state alternative cries out for solution! The end of zig-zag policy? 19 sanctions, anti-drone wall and economic dependence!

NDAHET NGA JETA ISH-KRYEMINISTRI FATOS NANO

Një nga personalitetet më ndikues të tranzicionit postkomunist, Nano la gjurmë të thella në historinë politike të vendit, duke udhëhequr Partinë Socialiste të Shqipërisë dhe duke shërbyer në disa mandate si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë.

Fatos Nano u lind më 16 shtator 1952 në Tiranë, në një familje të lidhur me artin dhe kulturën. Ai përfundoi studimet për ekonomi politike në Universitetin e Tiranës dhe më vonë ndoqi specializime jashtë vendit, përfshirë Vjenën, ku ishte studiues pranë Institutit të Studimeve Ekonomike të vendeve të Lindjes.



MBYLLET NJË EPOKE NË PARTINË SOCIALISTE DHE POLITIKËN SHQIPTARE

Shqipëria ka humbur sot një nga figurat më të njohura të politikës së saj moderne. Ish-kryeministri Fatos Nano është ndarë nga jeta në moshën 73-vjeçare, pas problemeve të rënda shëndetësore. Një nga personalitetet më ndikues të tranzicionit postkomunist, Nano la gjurmë të thella në historinë politike të vendit, duke udhëhequr Partinë Socialiste të Shqipërisë dhe duke shërbyer në disa mandate si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë. Me stilin e tij të veçantë dhe qasjen e drejtëpërdrejtë ndaj çështjeve politike, ai mbetet një figurë që ka ndikuar në mënyrë të thellë jetën publike dhe debatin politik shqiptar për më shumë se tri dekada.

Jeta dhe vepra e

ish-Kryeministrit Fatos Nano

Fatos Nano u lind më 16 shtator 1952 në Tiranë, në një familje të lidhur me artin dhe kulturën. Ai përfundoi studimet për ekonomi

politike në Universitetin e Tiranës dhe më vonë ndoqi specializime jashtë vendit, përfshirë Vjenën, ku ishte studiues pranë Institutit të Studimeve Ekonomike të vendeve të Lindjes.

Ai mori titullin “Doktor i Shkençave” në fushën e ekonomisë në vitin 1983, më pas “Profesor Doktor” dhe dy tituj “Doktor Honoris Causa” nga Universiteti Ndërkombëtar i Milanos dhe Universiteti i Barit në vitin 2000. Në vitet ’80, Nano punoi në institucione ekonomike shtetërore dhe ishte ndër të paktët intelektualë që fliste për hapjen graduale të ekonomisë shqiptare. Në vitin 1990 u emërua Kryeministër nga Ramiz Alia, një pozicion që do t’i shërbente si trampolinë politike për fazën e re të jetës së tij.

Në qershor 1991, gjatë Kongresit të 10-të të Partisë së Punës, partia u rilind si Partia Socialiste e Shqipërisë, me Fatos Nanon kryetar të parë. Ai e orientoi PS-në drejt një modeli so-

cialdemokrat perëndimor, duke përfshirë intelektualë të rinj dhe duke e integruar partinë në Internacionalen Socialiste.

Në vitin 1993, Nano u arrestua nga qeveria e Sali Berishës për akuza politike dhe qëndroi në burg rreth katër vjet, duke udhëhequr partinë nga qelia dhe duke e përgatitur PS-në për rikthim në pushtet.

Pas krizës së vitit 1997 dhe rënies së skemave piramidale, tre muaj pasi kishte dalë nga burgu, Nano udhëhoqi socialistët drejt rikthimit në pushtet duke mbajtur për 8 vite.

Ai ka shërbyer pesë herë si kryeministër (25 korrik 1997 – 23 prill 1998; 25 korrik 1997 – 23 prill 1998; 25 korrik 1997 – 23 prill 1998; 25 korrik 1997 – 23 prill 1998; 25 korrik 1997 – 23 prill 1998) dhe për 14 vjet e 1 muaj si kryetar i Partisë Socialiste, përfshirë vitet e burgut kur socialistët vendosën ta mbajnë kryetar.

Në vitin 2023, Kryeministri Edi Rama i akordoi Fatos Nanos “Kordonin e Madh me Yll të Mirënjohjes Publike”, për kontributin e shquar në ndërtimin e shtetit kushtetues dhe demokratik, si dhe për reformimin dhe modernizimin e Partisë Socialiste.

Me ndarjen nga jeta të Fatos Nanos mbyllet një kapitull i rëndësishëm i politikës shqiptare. Ai ishte një figurë që ndikoi thellë në formësimin e Partisë Socialiste dhe në rrugëtimin demokratik të vendit. Përtej debateve e ndasive që shoqëruan karrierën e tij, mbetet e pamohueshme se Nano la pas një trashëgimi të dukshme në politikën dhe jetën publike shqiptare. Kujtimi i tij do të ruhet si pjesë e historisë së tranzicionit dhe i përpyekjeve për një Shqipëri më moderne e më demokratike.



Përcillet në banesën e fundit me nderimet më të larta shtetërore ish-lideri i Partisë Socialiste dhe ish-kryeministri Fatos Nano



Fatos Nano, ish-kryeministër dhe lider historik i Partisë Socialiste, u nda nga jeta më 31 tetor 2025, duke lënë një boshllëk të thellë në politikën shqiptare. Ai është kujtuar dhe nderuar me homazhe solemne në Pallatin e Kongreseve, ku morën pjesë personalitete të shumta nga fusha të ndryshme, përfshirë politikanë, diplomatë, dhe qytetarë të thjeshtë. Vdekja e tij shënon fundin e një epoke të rëndësishme për Shqipërinë, duke e bërë 2 nëntorin një ditë zie kombëtare në nderim të trashëgimisë së tij politike dhe kontributit të pazëvendësueshëm në ndërtimin e shtetit shqiptar. Në Pallatin e Kongreseve u zh-

villuan sot homazhet, ku u vendosën kurora me lule nga qytetarë dhe personalitete nga fusha të ndryshme, ndërkohë që në vijim, nga ora 11:15-11:45, u zhvilluan homazhet e personaliteteve shtetërore dhe të trupit diplomatik. Në homazhe morën pjesë, Kryeministri Edi Rama dhe bashkëshortja Lind Rama, Kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, zv/kryeministrja njëherësh ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku, ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, Elisa Spiropali, ministrja e Brendshme Albana Koçiu si dhe ministra të tjerë të kabinetit qeveritar.

Po ashtu homazhe zhvilluan edhe

ish-kryeparlamentari Gramoz Ruçi, Sekretari i Përgjithshëm i PS-së, Blendi Klosi, kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla si dhe deputetë të grupit parlamentar të Partisë Socialiste dhe personalitete me kontribute në këtë forcë politike.

Në nderim të ish-kryeministrit Fatos Nano, në Pallatin e Kongreseve zhvilluan po ashtu homazhe edhe përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë.

Të pranishëm në homazhe ishin edhe deputetë të grupit parlamentar të Partisë Demokratike, si Agron Gjekmarkaj dhe Flamur Noka, si dhe politikanë të tjerë nga opozita, si Agron Duka, kreu



i Partisë Agrare Ambientaliste, apo Fatmir Mediu i Partisë Republikane, po ashtu dhe ish kreu i PD, Lulzim Basha. Në homazhe morën pjesë dhe drejtues të pushtetit lokal. Po ashtu të pranishëm në homazhe ishin edhe kryekomisioneri i KQZ, Ilirian Celibashi, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, Holta Zaçaj dhe zyrtarë të tjerë të lartë shtetëror.

Po ashtu në homazhe mori pjesë dhe ish-presidenti Alfred Moisiu, si dhe ish-presidenti Bamir Topi. Në homazhe parakaluan dhe politikanë nga rajoni, si kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, apo Ali Ahmeti i Partisë Bashkimi Demokratik për Integrim në Maqedoninë e Veriut.

Ndërkohë përfaqësues të komuniteteve fetare në vend, akademikë, artistë, gazetarë e përfaqësues të fushave të ndryshme ishin të pranishëm në hollin e Pallatit të Kongreseve dhe kaluan me radhë për të kryer nderimet e fundit në kujtim të ish-kryeministrit Fatos Nano.

Në një prononcim për mediet, pas homazheve, ish-kryeparlamentari Ruçi u shpreh se Fatos Nano ishte themeluesi dhe reformuesi i PS-së. “Nuk ka për të ndodhur më që në harkun e 14 viteve, 4 vite t’i kalosh në izolim dhe 8 vjet ta

mbash forcën politike në pushtet, pikërisht në dekadën e parë të themelimit dhe transformimit të kësaj force politike, si asnjë forcë tjetër politike simotër në Evropën lindore. Do të mbahet mend si i pari që tezën se ai tha që kur erdhi në pushtet për të krijuar shtet, e bëri realitet kur ishte vetë në pushtet, duke i hapur rrugën dy djemve të rinj të PS-së për tu bërë kryeministrá”, tha Ruçi.

Në një prononcim për mediet pas homazheve, deputeti socialist Erion Braçe vlerësoi rolin e Fatos Nanos në reformimin e Partisë Socialiste. Braçe tha se Nano nuk i mohoi askujt mundësinë për t’u rritur, zhvilluar dhe bërë karrierë brenda PS-së.

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë, Tedi Blushi u shpreh për mediet e Fatos Nano do të kujtohet si një figurë politike kyçe e tranzicionit shqiptar, i cili pati meritën e transformimit të Partisë së Punës, në një parti socialdemokrate europiane.

Homazhet publike nisën prej orës 8:30, ndërsa në përfundim të ceremonisë në orën 12:05, trupi i pajetë i Nanos u nis drejt banesës së fundit, në Sharrë. Në dalje të pallatit të Kongreseve arkëmorti u shoqërua dhe me tingujt e këngës së preferuar të liderit historik të

PS “My Way”, të “Frank Sinatra”. Ndërkohë qindra qytetarë hodhën karafila të bardhë, mbi arkivolin e liderit historik të PS.

Pas përfundimit të homazheve në Pallatin e Kongreseve, arkëmorti i ish-kryeministrit Nano u shoqërua përgjatë Bulevardit Dëshmorët e Kombit në drejtim të ish zyrës së tij në godinën e Këshillit të Ministrave, ku u ndal për pak minuta. Pas kësaj ndalese simbolike, kortezhi ju drejtua varrezave të sharrës, ky lideri historik i PS do të prehet në banesën e fundit.

Në respekt për kontributin e Fatos Nanos në jetën publike dhe politike të vendit, 2 nëntori është shpallur edhe ditë zie kombëtare.

Të gjithë flamujt në institucionet shtetërore janë ulur në gjysmë shtizë, ndërsa në orën 12:00 do të ndalojë çdo aktivitet për të mbajtur një minutë heshtje.

Fatos Nano ndërroi jetë në 31 tetor, në moshën 73-vjeçare, në një prej spitaleve private të kryeqytetit, ku po kurohej prej 24 ditësh.

Fatos Nano do të mbahet mend si një lider historik i së majtës shqiptare, vizionar për Shqipërinë dhe një nga figurat më të rëndësishme të politikës shqiptare gjatë periudhës së tranzicionit.



Nga **ARBEN CICI**

AMBASADOR

Në historinë e shekullit XX ka pak çaste që e kanë përkufizuar aq fuqishëm fatin e një kontinenti sa fjalia e famshme e Presidentit amerikan Ronald Reagan, e shqiptuar më 12 qershor 1987, përballë Portës së Brandenburgut: “Mr. Gorbachev, tear down this wall!”. Ishte një thirrje që në atë kohë mund të dukej e pamundur, një provokim politik për udhëheqësin e Bashkimit Sovjetik, një sfidë për tërë sistemin e ngritur mbi ndarje, frikë dhe kontroll. Por ajo fjali mbeti në ajër si një betim i historisë, derisa, vetëm dy vjet më pas, më 9 nëntor 1989, Muri i Berlinit ra dhe më 3 tetor 1990 Gjermania u bashkua, duke shënuar jo vetëm fundin e një strukture betoni, por shembjen e një epoke të gjatë dhe të mundimshme të Luftës së Ftohtë.

Për një gjerman të ndarë nga vël-lai i tij në anën tjetër të murit, rënia ishte rilindje. Për një evropian të Perëndimit, ishte triumf i demokracisë dhe i lirisë mbi tiraninë. Por për një shqiptar të viteve 80, të rritur brenda murit më të mbyllur dhe më hermetik të kontinentit, ky moment kishte një kuptim të dyfishtë: ishte shpresë,

MR. GORBACHEV, TEAR DOWN THIS WALL!



Muri i Berlinit nuk ishte thjesht një strukturë arkitektonike. Ai ishte një plagë që ndante trupin e një kombi, një vijë e dhimbshme që e shndërronte Berlinin në një qytet të dyfishtë: dritë dhe hije, shpresë dhe frikë, liri dhe nënshtrim. Ai mur ishte simboli më i prekshëm i Luftës së Ftohtë, shenjë e një bote të ndarë mes dy ideologjive që nuk mund të pajtoheshin.

por edhe dhimbje. Sepse ndërsa gurët e Murit të Berlinit binin nën duart e njerëzve të lirë, muri i brendshëm i Shqipërisë dukej

ende i patundur, një burg i hekurt i vendosur jo vetëm rreth kufijve, por edhe brenda mendjes e shpirtit të çdo qytetari.

Muri i Berlinit nuk ishte thjesht një strukturë arkitektonike. Ai ishte një plagë që ndante trupin e një kombi, një vijë e dhimbshme që e shndërronte Berlinin në një qytet të dyfishtë: dritë dhe hije, shpresë dhe frikë, liri dhe nënshtrim. Ai mur ishte simboli më i prekshëm i Luftës së Ftohtë, shenjë e një bote të ndarë mes dy ideologjive që nuk mund të pajtoheshin. Në Perëndim, një qytet që jetonte me gjallërinë e demokracisë, lirisë së tregut të kapitalizmit, në Lindje, një botë e zyrtë, e heshtur dhe e mbajtur dhunshëm me polici, spiunë dhe kontroll. Përtej tij nuk ishin thjesht dy sisteme, por dy mënyra të të jetuarit, dy vizione

të njeriut dhe të lirisë.

Në Shqipëri, megjithëse nuk kishim një mur fizik në mes të Tiranës, muri ynë ishte më i madh, më i pakapërcyeshëm dhe më i heshtur e i frikshëm. Ai ishte muri i izolimit total, i një regjimi që u shkëput jo vetëm nga Perëndimi, por edhe nga Lindja, duke u mbyllur në vetvete si një fortesë e çmendur brenda çmendurisë së saj. Për një djalë a vajzë të re shqiptare në vitet 80, dëgjimi i lajmit për fjalimin e Reaganit apo për lëvizjet e Gorbaçovit dukej i largët, thua-jse si një përrallë që vinte nga një planet tjetër ose një shpresë e dhimbshme e pakapshme. Megjithatë, shpresa nuk shuhet kurrë. Në qetësinë e frikshme të diktaturës, ku librat kontrolloheshin, ku fjalët e tepërta sillnin burg, ku kufiri ishte i blinduar me tela dhe gjemba, një çarje e vogël e murit europian jehonte si një thirrje e madhe në shpirtin tonë: edhe ky realitet do të ndryshojë.

Rënia e Murit të Berlinit ishte shumë më tepër sesa një akt i gjeopolitikës. Ajo ishte një revolucion i shpejtë dhe pa gjak, një përmbysje e rrufeshme, një shembull i fuqisë së njerëzve kur thyjnë frikën dhe vendosin të jetojnë të lirë. Me mijëra berlinezë, lindorë e perëndimorë, u ngjiten mbi mur atë natë, duke festuar jo vetëm ribashkimin e qytetit të tyre, por një lindje të re për gjithë Evropën. Njerëzit qanin, përqafojnë të panjohur, i binin me çekiç gurëve dhe çdo copë betoni që binte tingëllonte ishte si një thyerje e zinxhirëve të padukshëm të historisë. Ishte një spektakël i lirisë, i ngjashëm



Rënia e Murit të Berlinit ishte shumë më tepër sesa një akt i gjeopolitikës. Ajo ishte një revolucion i shpejtë dhe pa gjak, një përmbysje e rrufeshme, një shembull i fuqisë së njerëzve kur thyjnë frikën dhe vendosin të jetojnë të lirë. Me mijëra berlinezë, lindorë e perëndimorë, u ngjiten mbi mur atë natë, duke festuar jo vetëm ribashkimin e qytetit të tyre, por një lindje të re për gjithë Evropën.

me rilindjen e një kombi pas një shekulli errësire.

Politikisht, ky moment hapi rrugën për ribashkimin e Gjermanisë, përfundimin e Traktatit të Varshavës dhe për shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë. Europa Qendrore dhe Lindore, të mbajtura për dekada nën ndikimin sovjetik, panë mundësinë për të zgjedhur vetë rrugën e tyre. Polonia, Hungaria, Çekosllovakia, të gjitha nisën të hapnin dyert, dhe rrëzimi i regjimeve komuniste u bë dominoja që ra njëra pas tjetrës. Sllovenia, Kroacia, Maqedonia, Bosnja Hercegovina vendosën shkëputjen nga Jugosllavia. Kosova dhe shqiptarët atje kërkuan lirinë e munguar prej shekujsh. Liria u përhap

si një flakë e shenjtë në një pyll të tharë.

Në Shqipëri, kjo flakë vonoi. Por nuk ishte e mundur të ndalej. Në fund, rënia e Murit të Berlinit shënoi edhe fillimin e fundit të murit shqiptar. Sepse në një botë që ndryshonte me shpejtësi, izolimi ynë u bë i padurueshëm. Lajmet depërtuan, njerëzit panë se komunizmi mund të bjerë pa luftë, se diktaturat nuk janë të përjetshme dhe se Perëndimi nuk ishte armiku i shpifur nga propaganda, por një hapësirë shprese dhe lirie. Studentët shqiptarë që dolën në rrugët e Tiranës në dhjetor 1990 mbanin në mendje jo vetëm varfërinë e tyre, por edhe imazhet e njerëzve mbi Murin e Berlinit që festonin.

Për të gjithë ne, atëherë të rinj të mbyllur në një qytet pa ngjyra, rënia e Murit ishte një ëndërr e largët, por e prekshme në zemër. Ne jetonim pas një muri që nuk mund ta preknim me duar, por e ndienim në çdo hap. Ishte muri i heshtjes, i propagandës së detyruar, i frikës nga fqinji që mund të spiunonte, i dhunës së një sistemi ateisto-komunist qelizor, i drynizimit të informacionit, i kufirit të paarrtshëm. Ndërsa shihnim në televizion imazhet e berlinezëve që përqafojnë njëri-tjetrin, të gjithë ne mendonim: “Po ne, a do ta shohim ndonjëherë këtë ditë?”. Dhe përgjigjja vinte si një jehonë e brendshme: muret nuk janë të përjetshëm.

Sot, në përvjetorin e bashkimit të Gjermanisë e rënies së Murit të Berlinit, kujtojmë jo vetëm fundin e një epoke, por lindjen e një bote të re. Muri nuk ra vetëm për gjermanët. Ai ra për të gjithë ata që kishin jetuar të ndarë nga liria. Ai

ra për polakët e Solidarnosit, për çekët që kishin kujtime nga Praga e pushtuar në 1968, për hungarezët që guxuan të hapnin kufirin, për baltët që këndonin këngë lirie, për rumunët që rrëzuan diktatorin e tyre me gjak. Dhe ai ra edhe për studentët shqiptarët dhe për të gjithë shqiptarët, që edhe pse të fundit, dolën nga izolimi i tyre absurd dhe morën frymë lirisht.

Thirrja e Reaganit drejtuar Gorbaçovit nuk ishte vetëm një shuplakë politike. Ishte një mesazh moral: nuk mund të ketë paqe dhe siguri kur kombet jetojnë të ndarë nga mure. Nuk mund të ketë liri të vërtetë kur njerëzit jetojnë me frikë. Dhe sot, ndërsa shohim se në botë sërish po ngrihen mure të reja, qoftë fizike, qoftë ideologjike, qoftë sociale, qoftë kulturore apo fetare, duhet të kujtojmë se muret janë gjithmonë plagë, kurse urat janë shërim.

Muri i Berlinit ra sepse njerëzit nuk e pranuan më. Sepse një brez i ri e kuptoi se e ardhmja nuk ndërtohet mbi ndarje. Sepse udhëheqës si Gorbaçovi kishin guxim të mos përdornin tanket, por të lejonin ndryshimin. Sepse Perëndimi nuk e braktisi kauzën e lirisë. Dhe sepse historia, në fund, gjithmonë e gjen rrugën për të thyer padrejtësinë.

Për ne shqiptarët, rënia e Murit të Berlinit mbetet një nga ato çaste që na treguan se edhe muret më të fortë shemben. Sot, kur shëtisim lirshëm në Berlin dhe mund të prekim fragmentet e atij muri të ruajtura si kujtesë, ndjejmë një trishtim dhe një gëzim njëkohësisht. Trishtim për të gjithë

ata që jetuan dhe vdiqën në hijen e tij, por edhe gëzim sepse ai mur nuk ekziston më. Dhe kur shohim fragmentet e murit që sot janë bërë piktura të lirisë, ku artistët kanë vizatuar ngjyra dhe simbole, kuptojmë se historia jo vetëm shkatërron, por edhe shëron.

Në këtë përvjetor, kujtesa jonë shkon edhe më tej: drejt mureve të tjerë që ende ekzistojnë, drejt ndarjeve që ende plagosin botën. Por mesazhi i 1989 mbetet i qartë: liria nuk ndalet me beton. Shpre-

- 10 -

THERE IS ONE SIGN THE SOVIETS CAN MAKE THAT WOULD BE UNMISTAKABLE, THAT WOULD ADVANCE DRAMATICALLY THE CAUSE OF FREEDOM AND PEACE.

GENERAL SECRETARY GORBACHEV, IF YOU SEEK PEACE /- IF YOU SEEK PROSPERITY FOR THE SOVIET UNION AND EASTERN EUROPE /- IF YOU SEEK LIBERALIZATION / COME HERE, TO THIS GATE.

MR. GORBACHEV, OPEN THIS GATE.

MR. GORBACHEV, TEAR DOWN THIS WALL.

I UNDERSTAND THE FEAR OF WAR AND THE PAIN OF DIVISION THAT AFFLICT THIS CONTINENT /- AND I PLEDGE TO YOU MY COUNTRY'S EFFORTS TO HELP OVERCOME THESE BURDENS. TO BE SURE, WE IN THE WEST MUST RESIST SOVIET EXPANSION. SO WE MUST MAINTAIN DEFENSES OF UNASSAILABLE STRENGTH.

YET WE SEEK PEACE. SO WE MUST STRIVE TO REDUCE ARMS ON BOTH SIDES.

sa nuk shuhet me tela me gjemba. Dhe e vërteta nuk mbyllet brenda një kufiri të hekurt.

Për një të ri shqiptar të viteve 80, rënia e Murit të Berlinit ishte si një dritë që shndriti në horizont, një dritë që vonoi të arrinte, por që më në fund erdhi. Dhe sot, ndërsa shohim mbrapa, e kuptojmë se ato fjalë të thjeshta, "Mr. Gorbachev, tear down this wall!", nuk ishin vetëm një apel për një mur, por një betim për gjithë njerëzimin: që asnjë mur nuk duhet të mbajë peng lirinë e njeriut.

Në kujtesën e kolegëve, miqve dhe lexuesve të tij, Bugajski do të mbetet një simbol i përkushtimit ndaj së vërtetës dhe drejtësisë. Ai i kushtoi jetën kërkimit të zgjidhjeve të qëndrueshme për konfliktet ndërkombëtare, duke promovuar dialogun dhe kuptimin ndërkulturor. Analizat e tij mbi Ballkanin dhe Euroazinë ishin gjithmonë më shumë se komente politike; ato ishin udhërrëfyes për ata që kërkonin të ndërtonin një botë më të drejtë dhe më të lirë.

” Lamtumira e parakohëshme për Janusz Bugajskin, udhëprijësin e mendimit dhe vizionit të politikës ndërkombëtare



Nga Albert Vataj

Ndër njerëzit që lënë gjurmë të pakta por të pashlyeshme në historinë e mendimit politik dhe diplomacisë, Janusz Bugajski ishte një prej tyre. Analisti i shquar i çështjeve euroaziatike dhe ballkanike, i cili u nda nga jeta në moshën 71-vjeçare, la pas një trashëgimi intelektuale që tejkalon hartat e politikës dhe kufijtë e kohës.

Ai nuk ishte thjesht një studiues; ai ishte një udhëheqës i mendimit, një qytetar i botës që përdorte dijen dhe fjalën si mjete për të kuptuar dhe përmirësuar realitetin. Çdo libër, çdo analizë dhe çdo koment i tij mbartte peshën e përkushtimit të palëkundur ndaj

demokracisë, transparencës dhe lirisë së shtypit – vlera që ai nuk i shihte thjesht si teori, por si detyrë morale.

Lajmi për humbjen e tij erdhi nga miqtë, kolegët dhe bashkëpunëtorët e shumtë që e njohën për intelektin, integritetin dhe përkushtimin e tij ndaj vlerave universale të lirisë dhe demokracisë.

Ish-drejtori i Zërit të Amerikës, Elez Biberaj, shprehu me fjalë të ngrohta dhe prekëse trishtimin për humbjen e një miku dhe kolegu të jashtëzakonshëm: “Jam i tronditur dhe thellësisht i trishtuar kur mësova për ndarjen nga jeta të mikut dhe kolegut tim të ngushtë, Janusz Bugajski. Ai ishte një analist i shkëlqyer i çështjeve euroaziatike, autor i shumë veprave që ndikuan

ndjeshëm në kuptimin tonë për rajonin dhe një mbrojtës i vendosur i demokracisë, qeverisjes së mirë dhe lirisë së shtypit.”

Janusz Bugajski nuk ishte thjesht një analist; ai ishte një udhëheqës i mendimit dhe një vizionar i politikës ndërkombëtare, i cili i dha publikut dhe institucioneve një kuptim më të thellë të dinamikave komplekse të Ballkanit dhe Evropës Lindore. Përmes librave, artikujve dhe analizave të tij të sakta, ai ndihmoi në formësimin e politikave të rëndësishme dhe ndërgjegjësimin e opinionit publik për sfidat e demokracisë, të qeverisjes transparente dhe të lirisë së shprehjes.

Biberaj kujtoi me nostalgji vitet e shumta të bashkëpunimit: “E admiroja jo vetëm për intelektin e tij, por edhe për integritet-

tin, humorin dhe përkushtimin e palëkundur ndaj vlerave që ai i vlerësonte shumë. Mungesa e tij do të ndihet thellë nga të gjithë ne që patëm privilegjin ta njihnim dhe të punonim me të. Do të më mungojë jashtëzakonisht shumë. U prehsh në paqe, Janusz.”

Në kujtesën e kolegëve, miqve dhe lexuesve të tij, Bugajski do të mbetet një simbol i përkushtimit ndaj së vërtetës dhe drejtësisë. Ai i kushtoi jetën kërkimit të zgjidhjeve të qëndrueshme për konfliktet ndërkombëtare, duke promovuar dialogun dhe kuptimin ndërkulturor. Analizat e tij mbi Ballkanin dhe Euroazinë ishin gjithmonë më shumë se komente politike; ato ishin udhërrëfyes për ata që kërkonin të ndërtonin një botë më të drejtë dhe më të lirë.

Humbja e tij është një thirrje për reflektim mbi rëndësinë e mendimit të pavarur, integritetit dhe pasionit për të vërtetën. Janusz Bugajski, me punën dhe jetën e tij, na la një trashëgimi të jashtëzakonshme, duke treguar se fjala, analiza dhe vizioni i përkushtuar mund të lënë gjurmë që tejkalojnë kufijtë e kohës.

Për Bugajskin, çdo çështje rajonale ishte një pasqyrë e mëdha e të drejtave dhe lirisë njerëzore, dhe çdo analizë kishte një qëllim të qartë: të ndihmonte në ndërtimin e një bote më të drejtë. Ballkani, me kompleksitetin e tij të pafund, nuk ishte thjesht një rajon gjeografik; ishte një sfidë për mendjen dhe një provë për integritetin e tij profesional. Me saktësi, kurajë dhe vizion, ai hulumtoi, vlerësoi dhe ofroi



zgjidhje që pasqyronin jo vetëm njohurinë, por edhe humanizmin e thellë që e karakterizonte.

Në çdo fjalë të tij, duke shkruar ose duke ligjruar, ndjehej një dashuri për demokracinë dhe për njerëzit, për nevojën që bota të kuptonte se liria dhe drejtësia nuk janë luks, por themel i çdo shoqërie të shëndoshë. Analizat e tij nuk ishin thjesht reflektime akademike; ato ishin udhërrëfyes për ata që besojnë se dijet dhe integriteti janë armët më të

forta kundër padrejtësisë.

Humbja e Janusz Bugajski është e thellë, sepse ajo nuk prek vetëm një individ apo një komunitet profesional. Ajo prek çdo mendje të hapur që kërkon të kuptojë, të ndikojë dhe të mbrojë vlerat që e bëjnë jetën të vlefshme. Ai na mëson se intelektualiteti dhe etika nuk mund të ndahen, dhe se përkushtimi ndaj së vërtetës shpesh kërkon sakrificat e mëdha, por mbetet gjithmonë i pavdekshëm.

“Kina nuk zgjedh mes Moskës dhe Uashingtonit - zgjedh veten”

NGA ETTORE SEQUI*

Vendimi i Pekinit për të pezulluar blerjet e naftës ruse, pas sanksioneve amerikane ndaj kompanive Rosneft dhe Lukoil, është një zgjedhje ekonomike me domethënie politike të thellë. Ky hap është njëkohësisht një lëvizje taktike dhe sinjal afatgjatë, që shtrihet në kryqëzimin mes luftës në Ukrainë, konkurrencës strategjike SHBA-Kinë dhe ekuilibrit energjetik global. Nuk është një akt i izoluar: ai reflekton nevojën e dyfishtë të Pekinit për të mbrojtur sigurinë ekonomike dhe për të ruajtur hapësirën politike për dialog me Washington-in.

Koha e zgjedhur nuk është e rastësishme. Kina sapo përfundoi Plenumin e Katërt të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste, ku Xi prezantoi planin pesëvjeçar 2026-2030 dhe rishikoi prioritetet strategjike. Në të njëjtën kohë, po afron një takim i mundshëm mes Xi-së dhe Donald Trump-it në samitin APEC në fund të tetorit. Në negociatat për tarifën, Kina nuk mund të lejojë tensione me Washington-in. Pezullimi i përkohshëm i naftës ruse është një gjest qetësimi dhe sinjal pragmatizmi, për të krijuar klimë më të favorshme për një marrëveshje që të dyja fuqitë kërkojnë: ulje doganash, stabilitet të tregjeve dhe qasje më të mirë reciproke në mikroprocesorë dhe lëndë kritike.

Ekonomia kineze mbetet e



Pas vendimeve të Plenumit, Xi duhet të qetësojë një shoqëri të shqetësuar. Stabiliteti i çmimeve energjetike dhe siguria e furnizimeve janë thelbësore për të përmbytur pakënaqësinë dhe për të ruajtur rendin e brendshëm. Reduktimi i rrezikut nga sanksionet amerikane është kështu kujdes politik para se të jetë ekonomik. Pekini nuk do të priset me Moskën, por nuk do të sfidojë rendin financiar të dominohet nga dollari.

brishtë. Deflacioni shkatërron marzhet dhe besimin, papunësia e të rinjve rritet, dhe qeveritë lokale janë të ngarkuara nga borxhet. Prioritetet e Pekinit janë të garantojë rritje të mjaftueshme për të përmbytur papunësinë,

sidomos të të rinjve, dhe të shmangë “kurthin e të ardhurave të mesme”, që prek ekonomitë që pas zhvillimit të shpejtë bien në një periudhë stanjacioni.

Pas vendimeve të Plenumit, Xi duhet të qetësojë një shoqëri të shqetësuar. Stabiliteti i çmimeve energjetike dhe siguria e furnizimeve janë thelbësore për të përmbytur pakënaqësinë dhe për të ruajtur rendin e brendshëm. Reduktimi i rrezikut nga sanksionet amerikane është kështu kujdes politik para se të jetë ekonomik. Pekini nuk do të priset me Moskën, por nuk do të sfidojë rendin financiar të dominohet nga dollari. Kina flet shpesh për de-dollarizim, por e di se asnjë valutë alternative nuk mund të zëvendësojë sot dollarin në tregtinë e naftës.

Sanksionet amerikane godasin bërthamën e ekonomisë ruse, ndalojnë kompanitë të operojnë me dollarë dhe imponojnë



rreziqe të drejtpërdrejta për partnerët. Sanksionet dytësore shtrijnë kërcënimin edhe për bankat, sigurimet, tregtarët dhe transportuesit. Kompanitë e mëdha kineze nuk duan të ekspozohen. Më mirë pezullim dhe ruajtje e marzheve negociuese përpara samitit Xi-Trump.

Kina vepron në tre plane:

Ekonomik: mbron interesat në negociatat për tarifën, synon uljen e barrierave dhe konsolidimin e një ekuilibri të ri në zinxhirët e vlerës.

Politik: përgatit terrenin për takimin Xi-Trump, duke shmanhur gjestet armiqësore.

Strategjik: paralajmëron Moskën: bashkëpunimi vazhdon, por mbështetja nuk është e pakufizuar. Pekini nuk do të paguajë çmimin e luftës ruse as të sakrifikojë interesat teknologjike dhe financiare.

Sanksionet amerikane, të krijuara për të goditur Rusinë, dobësojnë lidhjen Pekin-Moskë. Trump e ka kuptuar këtë: deklaroi se Kina “mund të lehtësojë një zgjidhje” dhe dëshiron ta diskutojë me Xi-në. Kina, që përfiton nga vëmendja e reduktuar amerikane në Indo-Paqësor, synon tani koncesione konkrete: presion më i ulët mbi Tajvanin, më shumë fleksibilitet në eksportin e çipeve të avancuara dhe lehtësim të selektuar të doganave.

Sanksionet amerikane, të krijuara për të goditur Rusinë, dobësojnë lidhjen Pekin-Moskë. Trump e ka kuptuar këtë: deklaroi se Kina “mund të lehtësojë një zgjidhje” dhe dëshiron ta diskutojë me Xi-në. Kina, që përfiton nga vëmendja e reduktuar amerikane në Indo-Paqësor, synon tani koncesione konkrete: presion më i ulët mbi Tajvanin, më shumë fleksibilitet në eksportin e çipeve të avancuara dhe lehtësim të selektuar të doganave.

litet në eksportin e çipeve të avancuara dhe lehtësim të selektuar të doganave.

Për Moskën, pasojat janë të menjëhershme. Me Kinën dhe Indinë që reduktojnë blerjet, Rusia humb dy tregje që përthithin pjesën më të madhe të eksportit të saj të naftës. Nuk është goditje fatale, por dobësim struktural. Çdo fuçi e humbur i heq Kremlinin kohë dhe likuiditet. Është çmimi i një konflikti gjithnjë më të shtrenjtë dhe të vështirë për t'u mbajtur. Deri tani, Moska nuk ka reaguar ndaj vendimit kinez. Kremlinin e di se nuk

mund të heqë dorë nga Pekini, por kujdesi kinez tregon një varësi gjithnjë e më të pabarabartë. Për Ukrainën, këto dinamika hapin një mundësi. Sanksionet e reja amerikane, harmonizimi evropian mbi GNL dhe flotën ruse, dhe kujdesi kinez mbi blerjet energjetike, e bëjnë strategjinë e Putin-it më të shtrenjtë. Avantazhi rus me kalimin e kohës shkatërrohet, ndërsa Kina shndërron kujdesin në levë diplomatike. Mesazhi është i qartë: fuqia nuk gjendet më në pus, por në rrjedhat. Kush kontrollon pagesat, sigurimet dhe standardet ndërkombëtare, kontrollon shpejtësinë e parave, dhe kështu të luftës.

Në këtë ekuilibër të ri, Pekini lëviz me dy standarde: mbështet politikisht Moskën, por e kufizon ekonomikisht. SHBA-të godasin bërthamën e fuqisë ruse dhe fitojnë një kanal dialogu me Kinën, që megjithatë mbetet kundërshtari i tyre strategjik. Lufta mbetet e pasigurt, por peizazhi ndryshon: Azia nuk është më strehë për Rusinë, Kina nuk është partner i pakushtëzuar, dhe energjia është diplomacia e re e detyruar. Në këtë ekonomi të pushtetit, Kina nuk zgjedh mes Moskës dhe Uashingtonit: zgjedh veten.

**La Stampa*

EKSKLUZIVE/AMBASADORI I TURQISË, TAYYAR KAGAN ATAY

Shqipëria dhe Turqia, aleatë strategjike për stabilitet dhe zhvillim në Ballkan

“Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Turkiyes mbeten një nga bashkëpunimet më të forta dhe strategjike në rajonin e Ballkanit, të bazuara mbi historinë e përbashkët, vlerat kulturore dhe interesat e përbashkëta”. Në një intervistë shteruese për ARGUMENTUM.al, Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë, **SH.T.Z. Tayyar Kagan Atay** shpreh krenarinë për historinë e gjatë dhe të pasur që lidh dy vende, si dhe për zhvillimet e fundit në marrëdhëniet dypalëshe. Ai thekson se përvjetori i 102-të i marrëdhënieve diplomatike është dëshmi e një partneriteti të fuqishëm, të ndërtuar mbi trashëgiminë e përbashkët, lidhjet njerëzore dhe përkushtimin ndaj stabilitetit rajonal.

Ambasadori thekson se “Turqia dhe Shqipëria janë aleatë të fortë dhe miq të ngushtë me një histori bashkëpunimi dhe mirëkuptimi,” duke nënvizuar rëndësinë e vazhdimet të këtij partneriteti strategjik. Ai vë në pah rolin e bashkëpunimit ekonomik si shtyllën kryesore të marrëdhënieve dypalëshe. Në fushën ekonomike, Turqia është partneri i katërt më i madh tregtar i Shqipërisë, me një vëllim shkëmbimesh prej mbi 1 miliardë dollarë në vitin 2024 dhe synimin për të arritur 2 miliardë në të ardhmen e afërt. Investimet turke në Shqipëri arrijnë rreth 3.5 miliardë dollarë, duke përfshirë sektorë si infrastruktura, energjia, bankat dhe turizmi. Hapja e degës së Ziraat Bank në Tiranë në vitin

Intervistë Ekskluzive për ARGUMENTUM.al me Ambasadorin e Republikës së Turqisë në Tiranë, SH.T.Z. Tayyar Kagan Atay



2026 simbolizon besimin në potencialin ekonomik të Shqipërisë. “Ndërsa shifrat ekonomike japin një matje të rëndësishme të angazhimit tonë, ato nuk reflektojnë të gjithë pamjen. Për këtë arsye, dëshiroj të theksoj disa nga investimet e Turqisë në Shqipëri gjatë dekadës së fundit që kanë pasur një ndikim të prekshëm në jetën

e përditshme të shqiptarëve. Këto përfshijnë ndërtimin e Spitalit Memorial të Miqësisë Fier, projektin e banesave të TİKA-s pas tërmeteve në Shqipëri, hapjen e Xhamisë së Namazgjasë, restaurimin e strukturave historike të periudhës osmane, si dhe shumë projekte të tjera zhvillimore, arsimore dhe socio-kulturore të zba-

tuara nga TİKA. Të tilla iniciativa tregojnë se angazhimi i Turqisë në Shqipëri shkon përtej tregtisë, duke përfshirë zhvillimin social, ruajtjen kulturore të trashëgimisë së përbashkët historike dhe investime me fokus tek njerëzit”, theksoi ambasadori në këtë intervistë. Në fushën e politikës rajonale, ambasadori evidenton përkushtimin e Turqisë për stabilitet dhe paqe në Ballkan, duke theksuar se “Shqipëria është një partner i rëndësishëm në rajon dhe ne mbështesim fuqimisht rrugën e saj drejt integritimit evropian.”

Ambasadori nënvizon përkushtimin e Turqisë për paqe dhe stabilitet në Ballkan, duke mbështetur integritimin evropian dhe euroatlantik të Shqipërisë dhe vendeve të rajonit. Ai shpreh rëndësinë e bashkëpunimit me Shqipërinë në kuadër të NATO-s dhe organizatave rajonale si SEECIP dhe BSEC. Turqia e konsideron Shqipërinë një partner kyç për përballimin e sfidave rajonale.

Në vitin 2026, Turqia do të presë Samitin e NATO-s, i cili do të ndiqet nga Samiti i NATO-s në Shqipëri në vitin 2027. Koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë mes dy vendeve tona në përgatitjen dhe realizimin e këtyre samiteve kyçe përbën një tjetër dimension të bashkëpunimit konkret dypalësh.

Gjithashtu, ai nënvizon rolin e Turqisë si një urë lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit, duke theksuar nevojën për dialog dhe bashkëpunim ndërkombëtar në kohën e sfidave globale.

“Turqia ka një rol të veçantë si ndërmjetëse dhe bashkëpunuese në skenën globale, duke lidhur kultura dhe interesa nga Lindja në Perëndim dhe duke promovuar dialogun ndërkombëtar si rruga drejt paqes dhe prosperitetit.”

Në këtë kontekst, roli i Turqisë në

Ambasadori nënvizon përkushtimin e Turqisë për paqe dhe stabilitet në Ballkan, duke mbështetur integritimin evropian dhe euroatlantik të Shqipërisë dhe vendeve të rajonit. Ai shpreh rëndësinë e bashkëpunimit me Shqipërinë në kuadër të NATO-s dhe organizatave rajonale si SEECIP dhe BSEC. Turqia e konsideron Shqipërinë një partner kyç për përballimin e sfidave rajonale.

Ballkan shikohet jo vetëm si një faktor stabiliteti, por edhe si një mbështetje e fuqishme për bashkëpunimin dhe zhvillimin rajonal, duke kontribuar në forcimin e marrëdhënieve midis vendeve dhe në avancimin e projekteve strategjike që pasurojnë perspektivat e zhvillimit të përbashkët, thekson Ambasadori i Turqisë në Tiranë, SH.T.Z. Tayyar Kagan Atay në intervisten e mëposhtme:

**Intervistoi: Marjana DODA
KRYEREDAKTORE**

-I nderuar Ambasador, së pari ju falënderoj që pranoni këtë intervistë ekskluzive për Argumentum.al, veçanërisht në prag të 102-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike midis Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë. Si do ta përshkruanit gjendjen aktuale të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve tona? Cilat janë momentet kyçe që po formësojnë dhe thellojnë këtë partneritet strategjik?

SH.T.Z. Tayyar Kagan Atay:

Faleminderit që gjetët kohë për të zhvilluar këtë intervistë. Uroj që lexuesit tuaj ta shijojnë këtë bisedë të këndshme.

Le të fillojmë duke rikujtuar se marrëdhëniet shqiptaro-turke shtrihen përtej marrëdhënieve diplomatike dhe kanë shekuj histori të përbashkët. E kaluara jonë e përbashkët gjatë periudhës osmane përbën një vlerë të çmuar për të dy kombet. Turqit dhe shqiptarët

janë popuj vëllezër, dhe lidhjet tona të thella shoqërore e kulturore, të cilat burojnë nga kjo bashkëjetesë shumë-shekullore, e bëjnë marrëdhënien shqiptaro-turke të veçantë dhe unike.

Duke folur për historinë tonë të përbashkët, sjell në vëmendje se shqiptarët kanë mbajtur poste të rëndësishme në nivel shtetëror gjatë periudhës osmane. Shumë funksionarë të lartë me origjinë shqiptare kanë shërbyer si vezirë të mëdhenj, një post që në atë kohë përfaqësonte Kryeministrin. Dihet se rreth 35 Vezirë të Mëdhenj kanë qenë me origjinë shqiptare.

Në këtë pikë, dua të përmend disa figura të njohura që kanë lënë gjurmë të thella në historinë dhe letërsinë e të dy kombeve. Ky element është një nga faktorët që formëson marrëdhëniet e ngrohta që gëzojmë sot me Shqipërinë. Një nga mjeshtrat dhe reformatorët më të mëdhenj të gjuhëve turke dhe shqipe, Shemsedin Sami (ose Sami Frashëri në shqip), është autori i romanit të parë turk *Taşuk-ı Talat ve Fitnat*, i fjalorit të parë turqisht-turqisht *Kamus-ı Türki* dhe i enciklopedisë së parë turke *Kamus-ul Alam*. Djali i tij, Ali Sami Yen, është themeluesi i klubit të futbollit Galatasaray, një prej skuadrave më të njohura sportive në Evropë. Mehmet Akif Ersoy, poet, shkrimtar, akademik, politikan dhe autor i Himnit Kombëtar të Turqisë,

është një vlerë e përbashkët e kombeve turk dhe shqiptar.

Për më tepër, lagjja në Stamboll ku janë vendosur shqiptarët që nga shekulli XV njihet sot si Arnavutköy (“Fshati i Shqiptarëve”). Gjurmë të shumta të historisë dhe kulturës sonë të përbashkët gjenden gjithashtu në Shqipëri – në Tiranë, Elbasan, Korçë, Krujë, Berat, Shkodër, Gjirokastrë, Vlorë – pothuajse në çdo cep të vendit. Është përgjegjësi e përbashkët e jona ta përcjellim këtë trashëgimi historike të përbashkët, që na është lënë amanet nga historia, te brezat e ardhshëm. Në këtë kuadër, jemi të kënaqur që shumë projekte restaurimi janë realizuar nga Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim – e njohur si TİKA.

Në pak fjalë, përqafimi i së kaluarës gjithmonë ndihmon për të përgatitur të ardhmen. Asnjë ambasador tjetër në Tiranë nuk ka një avantazh të tillë si unë për të shfrytëzuar dhe ndërtuar mbi një trashëgimi të tillë. E konsiderojmë veten me fat në këtë drejtim dhe përpiqemi me përkushtim ta ruajmë dhe të vlerësojmë atë. Jemi të kënaqur dhe krenarë që shohim se miqësia dhe lidhjet tona të ngushta, të krijuara gjatë më shumë se 600 viteve, po forcohen dita-ditës. Përvjetori i 102-të i marrëdhënieve tona diplomatike që po afrohet, është një dëshmi e qartë e marrëdhënieve në rritje dhe thellim midis Turqisë dhe Shqipërisë. Dy kombet tona kanë kultivuar një partneritet të fuqizuar nga historia dhe trashëgimia e përbashkët, lidhjet njerëzore, përkushtimi ndaj stabilitetit rajonal, si dhe bashkëpunimi ynë brenda aleancës së NATO-s. Ndërsa Turqia dhe Shqipëria kanë qenë gjithmonë aleatë dhe partnerë të ngushtë, marrëdhëniet tona sot janë thelluar ndjeshëm në të gjitha fushat, që



Në foto: SH.T.Z. Tayyar Kagan Atay: Ambasador i Republikës së Turqisë në Shqipëri. **Marjana Doda,** Kryeredaktore, ARGUMENTUM.al

nga dialogu politik e deri te bashkëpunimi ekonomik dhe shkëmbimet kulturore. Në këtë kuadër, dialogu i vazhdueshëm dhe i drejtpërdrejtë midis Presidentit Erdoğan dhe Kryeministrit Rama ka luajtur një rol kyç në avancimin e bashkëpunimit tonë.

Një zhvillim i rëndësishëm në marrëdhëniet tona dypalëshe ishte përcaktimi i Turqisë si një nga pesë partnerët strategjikë të Shqipërisë në vitin 2013. Ky përcaktim u forcua më tej gjatë vizitës zyrtare të Kryeministrit Edi Rama në Turqi në vitin 2021, ku u nënshkrua një “Deklaratë e Përbashkët Politike” që ngriti

marrëdhëniet tona në nivelin e një “Partneriteti Strategjik” zyrtar. Me fjalë të tjera, partneriteti ynë strategjik u formalizua. Në praktikë, ky formalizim krijoi një mekanizëm Këshilli Bashkëpunimi në Nivel të Lartë, i cili mbledh periodikisht udhëheqësit dhe ministrat përkatës për të shqyrtuar dhe avancuar të gjitha aspektet e bashkëpunimit dypalësh. Deri më tani, janë mbajtur dy mbledhje të këtij Këshilli në Ankara dhe Tiranë gjatë vitit 2024. Takimi i tretë do të zhvillohet së shpejti në Ankara gjatë vizitës së ardhshme të Kryeministrit Rama në Turqi.

-Zoti Ambasador, Shqipëria dhe Turkiye janë cilësuar shpesh si partnerë strategjikë. Duke parë takimet e shpeshta mes drejtuesve të dy vendeve dhe bashkëpunimin e ngushtë në nivelet më të larta, çfarë pritshmëri ka Ankaraja nga qeveria ‘Rama 4’ për të çuar përpara këtë marrëdhënie?”

Presidenti Erdoğan dhe Kryeministri Rama gëzojnë një marrëdhënie të ngushtë miqësore, e cila ka shërbyer si një shtytës i rëndësishëm në avancimin e agjendës sonë bilaterale. Gjatë 12 muajve të fundit, Presidenti Erdoğan vizitoi Shqipërinë dy herë



Dy kombet tona kanë kultivuar një partneritet të fuqizuar nga historia dhe trashëgimia e përbashkët, lidhjet njerëzore, përkushtimi ndaj stabilitetit rajonal, si dhe bashkëpunimi ynë brenda aleancës së NATO-s. Ndërsa Turqia dhe Shqipëria kanë qenë gjithmonë aleatë dhe partnerë të ngushtë, marrëdhëniet tona sot janë thelluar ndjeshëm në të gjitha fushat, që nga dialogu politik e deri te bashkëpunimi ekonomik dhe shkëmbimet kulturore.



brenda një periudhe gjashtë mujore — fillimisht për një vizitë zyrtare më 10 tetor 2024, dhe më pas për të marrë pjesë në Samitin e 6-të të Komunitetit Politik Evropian (EPC) më 16 maj 2025. Vullneti i fuqishëm politik në nivel të lartë për thellimin e bashkëpunimit bilateral siguron lehtësira të konsiderueshme për veprimtarinë tonë diplomatike. Presim që ky momentum të vazhdojë gjatë mandatit të Qeverisë së Katërt Rama, duke ndjekur qëllime konkrete në përfundimin e marrëdhënieve tona me Shqipërinë. Në muajt në vijim, pritet që Kabineti i ri shqiptar të vizitojë Ankara-n për realizimin e takimit të tretë të Këshillit të Bashkëpunimit të Nivelit të Lartë.

Një nga prioritetet tona të përbashkëta mbetet arritja e një vëllimi tregtar bilateral prej 2 miliardë dollarësh, si dhe zgjerimi i bashkëpunimit në fushën e investimeve, infrastrukturës dhe sektorëve të tjerë strategjikë. Ekziston gjithashtu potencial i konsiderueshëm për një bashkëpunim më të thellë në fushën e mbrojtjes, ku synojmë të forcojmë lidhjet ekzistuese. Turkiye mbështet aktualisht përpjekjet e modernizimit të Forcave të Armatosura Shqiptare përmes furnizimit me pajisje, dorëzimeve dhe programeve të trajnimit, të cilat mund të pasurohen me projekte të përbashkëta në industrinë e mbrojtjes.

Gjithashtu, shpresojmë në vazhdimësinë e angazhimit të përbashkët në nisma rajonale dhe multilaterale, ku Shqipëria ka luajtur një rol aktiv dhe konstruktiv. Në vitin që po kalon, Shqipëria organizoi me sukses Samitin e Komunitetit Politik Evropian (EPC) dhe Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) në Tiranë. Në vitin 2026, Turkiye

do të presë Samitin e NATO-s, i cili do të ndiqet nga Samiti i NATO-s në Shqipëri në vitin 2027. Koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë mes dy vendeve tona në përgatitjen dhe realizimin e këtyre samiteve kyçe përbën një tjetër dimension të bashkëpunimit konkret dypalësh.

-Turqia është një nga partnerët ekonomikë më të rëndësishëm të Shqipërisë. A mund të na jepni disa shifra konkrete mbi vëllimin e shkëmbimeve tregtare midis dy vendeve? Gjithashtu, cilat janë sektorët kryesorë ku ekzistojnë mundësi më të mëdha për zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar

Turkiye ishte partneri i katërt më i madh tregtar i Shqipërisë gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2025, duke përbërë rreth 7.0 përqind të vëllimit total tregtar të Shqipërisë. Në këtë periudhë, vëllimi ynë tregtar arriti në afërsisht 550.9 milionë dollarë amerikanë. Nga kjo shumë, 509.4 milionë dollarë përfaqësoheshin nga eksportet turke, ndërsa 41.5 milionë dollarë nga importet. Presim që ky tregues të rritet deri në fund të vitit. Në vitin 2024, vëllimi ynë tregtar arriti në rreth 1.038 miliardë dollarë dhe të dy vendet janë të angazhuara për të arritur objektivin prej 2 miliardë dollarësh në të ardhmen e afërt.

Produktet turke të eksportit në Shqipëri janë kryesisht elektronikë, pjesë makinerish, tekstile, materiale ndërtimi, si dhe hekur dhe çelik. Importet kryesore nga Shqipëria në Turqi përfshijnë metale dhe xehe, metale me ngjyra, makineri gjeneruese të energjisë dhe lëndë të para shtazore, si dhe bimore. Duke marrë parasysh përbërjen e mallrave të tregtuara, ka ende hapësirë për të

diversifikuar dhe për të përfshirë teknologji me vlerë të shtuar më të lartë.

- Si e vlerësoni rolin e investimeve turke në Shqipëri në kuadër të zgjerimit të prezencës ekonomike të Turqisë në Ballkan, sidomos pas lajmit për hapjen e degës së Ziraat Bank në Tiranë? Përveç sektorit bankar, a ka plane për investime në projekte strategjike si infrastruktura, energjia apo turizmi?

Hapja e degës së Bankës Ziraat në Tiranë shënon një moment të rëndësishëm në praninë ekonomike të Turqisë në Ballkan. Dega do të jetë plotësisht funksionale që nga viti 2026. Kjo pasqyron besimin e investitorëve turq në tregun dhe potencialin e Shqipërisë. Investimet turke në Shqipëri janë tashmë të konsiderueshme, duke arritur në 3.5 miliardë dollarë amerikanë, me mbi 800 kompani që operojnë në një gamë të gjerë sektorësh, duke përfshirë bankat, minierat, energjinë, transportin ajror, infrastrukturën, shëndetësinë dhe turizmin. Turqia është një nga pesë investitorët kryesorë në Shqipëri. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2025, Turqia u rendit e para midis të gjithë investitorëve të huaj në Shqipëri me investime që arrinin një total prej 89 milionë eurosh. Ngjashëm, në vitin 2024 ishte gjithashtu investitori më i madh në vend duke kontribuar me 257 milionë euro.

Hapja e Degës së Shqipërisë të MÜSIAD, një prej shoqatave më të mëdha të biznesmenëve të Turqisë, vitin e kaluar, vendosi një shenjë të qartë besimi dhe vullneti nga pala turke për të forcuar dhe institucionalizuar më tej lidhjet tona tregtare. Dega MÜSIAD në Shqipëri, në bashkëpunim me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), do të or-

ganizojë Forumin e Investimeve Turqi-Shqipëri më 17 tetor 2025 në Tiranë, i cili do të shërbejë si një platformë për të bashkuar palët e interesuara të sektorit privat dhe për të na lejuar të vlerësojmë në mënyrë gjithëpërfshirëse lidhjet tona ekonomike në të ardhmen. Kryeministri Edi Rama dhe Zëvendës-presidenti i Turqisë Cevdet Yilmaz do të hapin së bashku Forumin e Investimeve. Ndërsa shifrat ekonomike japin një matje të rëndësishme të angazhimit tonë, ato nuk reflektojnë të gjithë pamjen. Për këtë arsye, dëshiroj të theksoj disa nga investimet e Turqisë në Shqipëri gjatë dekadës së fundit që kanë pasur një ndikim të prekshëm në jetën e përditshme të shqiptarëve. Këto përfshijnë ndërtimin e Spitalit Memorial të Miqësisë Fier, projektin e banesave të TİKA-s pas tërmeteve në Shqipëri, hapjen e Xhamisë së Namazgjasë, restaurimin e strukturave historike të periudhës osmane, si dhe shumë projekte të tjera zhvillimore, arsimore dhe socio-kulturore të zbatuara nga TİKA. Të tilla iniciativa tregojnë se angazhimi i Turqisë në Shqipëri shkon përtej tregtisë, duke përfshirë zhvillimin social, ruajtjen kulturore të trashëgimisë së përbashkët historike dhe investime me fokus tek njerëzit

– Në kontekstin e ndryshimeve të rëndësishme politike dhe ekonomike në Ballkan, si e shikon Turqia rolin e saj në Shqipëri dhe në rajon? Çfarë objektivash ka për të forcuar stabilitetin dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve të Ballkanit në afat mesëm dhe afat të gjatë?

Angazhimi ynë në Ballkan udhëhiqet nga parimet e pronësisë rajonale, përfshirjes dhe respektit për sovranitetin, duke theksuar se vendet e rajonit janë arkitektët kryesorë të së ardhmes së tyre. Në këtë kuadër, dialogu politik i

nivelit të lartë, siguria për të gjithë, integrimi ekonomik dhe ruajtja e strukturave shoqërore shumëetnike, shumëkulturore dhe shumëfetare të rajonit përbëjnë shtyllat kryesore të politikës ballkanike të Turqisë.

Vendosja e një paqeje dhe stabiliteti të përhershëm në rajon, ruajtja e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe siguri i bashkëpunimit rajonal janë ndër prioritetet tona. Si pjesë e fqinjësisë ballkanike, Turqia luan një rol konstruktiv në Ballkan. Në përpjekjet tona, ne e shohim Shqipërinë si një partner të natyrshëm dhe të fortë dhe përgëzojmë kontributet e rëndësishme të Shqipërisë për të ruajtur paqen e brishtë në rajon.

Arkitektura e re e sigurisë pas luftës në Ukrainë e bëri bashkëpunimin tonë, si dy aktorë të shquar në Ballkan dhe aleatë të NATO-s, edhe më të rëndësishëm. Ne e vlerësojmë mbështetjen konstruktive të Shqipërisë për përpjekjet ndërkombëtare për paqe dhe siguri. Jemi të kënaqur të mirëpresim Togën e Këmbësores së Forcave të Armatosura të Shqipërisë në kontingjentin tonë si pjesë e Operacionit EUFOR ALTHEA në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Integrimi evropian dhe euroatlantik i të gjitha vendeve të Ballkanit, pa diskriminim, ka qenë një nga shtyllat kryesore të politikës sonë ballkanike. Ne besojmë se e ardhmja e rajonit, të cilit i përket edhe Turqia, një vend kandidat për në BE, është brenda Bashkimit Evropian. Jemi të kënaqur që zgjerimi është rikthyer në axhendën e BE-së. Ne e përgëzojmë Shqipërinë për progresin e jashtëzakonshëm të negociatave të pranimit me BE-në. Shpresojmë që ky zhvillim pozitiv të përshpejtojë ritmin e përgjithshëm të procesit të zgjerimit të BE-së.

Turqia dhe Shqipëria janë gjithashtu të angazhuara në një bashkëpunim të fortë në organi-

zata rajonale dhe ndërkombëtare, të tilla si Kombet e Bashkuara, Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi (BSEC) dhe Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP). Ne jemi të vendosur të ruajmë solidaritetin tonë me Shqipërinë për të kontribuar në paqen rajonale dhe globale.

– Si e vlerësoni rolin dhe praninë e Turqisë në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë, veçanërisht në aspektet ekonomike, kulturore dhe ushtarake? Duke pasur parasysh sfidat dhe kërcënimet për stabilitetin rajonal, përfshirë ndikimet dhe qëndrimet e Serbisë, sa ndikon ky angazhim i Turqisë në përmirësimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit në Ballkan?

Kosova, si dhe Bosnja dhe Hercegovina, mbeten pikat e brishta në rajon. Si të tilla, të dy vendet zënë një vend të veçantë në qasjen rajonale të Turqisë. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, tendencat secesioniste përbëjnë kërcënimin më të rëndësishëm për paqen, ndërsa në Kosovë mungesa e përparimit në Procesin e Dialogut Prishtina-Beograd të lehtësuar nga BE-ja mbetet një çështje urgjente.

Turqia është e vendosur të vazhdojë angazhimin e saj dypalësh dhe rajonal përballë këtyre dy vendeve. Qëllimi ynë kryesor është të mbështesim sovranitetin dhe integritetin e tyre territorial. Nga një perspektivë politike, Turqia kontribuon në përpjekjet e ndërtimit të shtetit në Kosovë që nga fillimi dhe mbështet integrimin e saj në organizatat euro dhe euroatlantike. Ne gjithashtu promovojmë njohjen ndërkombëtare të Kosovës – Turqia ishte një nga vendet e para që e njohu Kosovën si të tillë në vitin 2008. Ne gjithashtu vazhdojmë të mbështesim Procesin e Dialogut Prishtina-Beograd. Në mënyrë të ngjashme, Turqia mbështet

pranimin e Bosnjës dhe Hercegovinës në strukturat euro dhe euroatlantike, ndërsa pozicionohet si një mundësues i dialogut midis Bosnjës dhe Hercegovinës dhe fqinjëve të saj, Serbisë dhe Kroacisë, përmes mekanizmave të konsultimit trepalësh.

Turqia ka dhënë kontribute të konsiderueshme trupash në operacionet e KFOR-it të NATO-s dhe EUFOR Althea për një kohë të gjatë. Në fakt, Turqia është vendi më i madh jo-anëtar i BE-së që kontribuon me trupa në EUFOR Althea. Rimarrja jonë e Komandës së KFOR-it të NATO-s që nga tetori i vitit 2025 pasqyron vullnetin tonë për të ndihmuar në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Ballkan.

Përtej angazhimit politik dhe kontributeve të sigurisë, angazhimi ekonomik dhe kulturor i Turqisë në rajon plotëson rolin e saj stabilizues në rajon.

-Shkëlqesia Juaj, Turqia ndodhet në një pozicion strategjik si urë lidhëse midis Lindjes dhe Perëndimit dhe ka luajtur rol ndërmjetësues në konflikte të rëndësishme si Ukraina, Siria, Azerbajxhani, dhe gjithashtu është një zë i fuqishëm për Palestinën. Në një botë të polarizuar dhe me interesat shpesh kontradiktore të fuqive të mëdha, a mundet Turqia vërtet të mbajë një qëndrim neutral dhe të luajë rol ndërmjetësues pa krijuar tensione të reja në politikën globale?

Turqia me të vërtetë ka një pozicion strategjik si urë midis Lindjes dhe Perëndimit, që i mundëson të marrë rolin e ndërmjetësit në konflikte në mbarë botën. Ajo nuk pretendon të jetë neutrale në çdo konflikt rajonal; përkundrazi, ajo i afrohet secilës palë në konflikt, edhe nëse janë në luftë, pa paragjykime dhe synon të gjejë një pikë të përbashkët dhe

të eksplorojë mënyrat për të ndaluar konfliktin në fjalë.

Për shembull, në rastin e Ukrainës, Turqia demonstroi pozicionin e saj unik duke ndërmjetësuar Iniciativën për Drithërat e Detit të Zi dhe duke lehtësuar shkëmbimet e të burgosurve midis Rusisë dhe Ukrainës.

Si një përkrahëse e paqes në Kaukazin e Jugut, Turqia mirëpreti përparimin e fundit drejt një paqeje të qëndrueshme midis Azerbajxhanit dhe Armenisë.

Situata në Siri, nga ana tjetër, është e natyrës tjetër. Këtu, sfida është rivendosja e shtetësisë, stabilitetit dhe kohezionit shoqëror pas viteve të konfliktit. Turqia mbështet Sirinë në përpjekjet për të fuqizuar kapacitetet institucionale dhe për të nxitur qeverisje gjithëpërfshirëse, ndërsa në të njëjtën kohë mbetet vigjilente ndaj përpjekjeve për të shfrytëzuar kushtet e brishta në terren dhe për të kërcënuar sigurinë e vet të Turqisë.

Turqia ka qenë një nga vendet më aktive diplomatikisht dhe një nga kritikët më të zëshëm të sulmit dyvjeçar të Izraelit ndaj Gazës. Ajo kërkoi veprime ndërkombëtare dhe bëri thirrje të përsëritura për një zgjidhje me dy shtete. Presidenti Recep Tayyip Erdoğan dhe Ministri i Punëve të Jashtme Hakan Fidan kanë dedikuar pjesën më të madhe të kohës dhe energjisë së tyre për të qenë zëri i palestinezëve në çdo forum ndërkombëtar. Këto përpjekje u fokusuan edhe në planin e fundit të paqes së Presidentit Trump për Gazën, duke theksuar se Izraeli duhet të ndalojë sulmet për të siguruar suksesin e këtij plani.

Përpjekjet e ndërmjetësimit të Turqisë shtrihen në fakt shumë përtej fqinjësisë së saj direkte. Turqia ka ndihmuar në lehtësimin e dialogut midis Somalisë dhe Somaliland-it dhe ka qenë kyçe në Deklaratën e Ankarasë

midis Etiopisë dhe Somalisë.

- I nderuar Ambasador, duke pasur parasysh sfidat dhe mundësitë me të cilat përballen vendet tona në dritën e zhvillimeve të ndryshme gjeopolitike globale, si e vlerësoni perspektivën afatgjatë të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Turqisë? Sipas jush, cilat janë objektivat kryesorë që dy vendet duhet të ndjekin për të forcuar më tej partneritetin strategjik në dekadat në vijim?

Shqipëria dhe Turqia ndajnë një marrëdhënie të gjatë dhe të qëndrueshme të ndërtuar mbi respekt të ndërsjellë, lidhje historike dhe interesa të përbashkëta rajonale. Duke parë përpara, shoh potencial të konsiderueshëm dhe nevojë për të thelluar Partneritetin tonë Strategjik, veçanërisht duke marrë parasysh zhvillimet në politikën ndërkombëtare. Bota po bëhet gjithnjë e më shumë shumëpolare, konfliktet rajonale po shtohen, dezinformimi po përhapet, dhe ndryshimet klimatike po krijojnë sfida të reja siç janë katastrofat natyrore dhe siguria ushqimore.

Një pjesë e rëndësishme e kapërcimit të këtyre sfidave është puna me partnerë të besueshëm. Besueshmëria është çelësi. Diskursi në diplomaci po ndryshon gjithnjë e më shumë duke favorizuar terma si “friend-shoring” në vend të “off-shoring”. Në këtë kontekst, si dy aleatë të NATO-s dhe kandidatë për BE, dhe vërtet vende vëllazërore, Shqipëria dhe Turqia kanë potencial të madh për të zgjeruar bashkëpunimin dhe Partneritetin Strategjik në dekadën që vjen. Ne tashmë ndajmë një vizion të përbashkët për një të ardhme të begatë në rajonin tonë dhe kemi shprehur vendosmërinë tonë të përbashkët për të konsoliduar më tej Partneritetin tonë Strategjik në të gjitha fushat.

Armëpushim po, paqe jo! Duhet zgjidhja me dy shtete! Fundi i politikës amerikane me zik-zake? 19 Sanksione, Muranti-dronë dhe Pavarësi ekonomike!

REAL POLITIK NR. 115 | 1 – 27 TETOR 2025 | EKSKLUZIVISHT PER FOR ARGUMENTUM

Komente “flash” mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, vetëm me 1000 fjalë nga analisti i njohur

DR. JORGJI KOTE

MJESHTËR I MADH NË DIPLOMACI

1.

Armëpushim po, paqe jo! Marrëveshja e Armëpushimit Izrael – Hamas e nënshkruar më 8 Tetor me ndërmjetësimin e Presidentit Trump i dha fund një periudhe dy vjetore makthi lidhur me fatin e 145 pengjeve, prej të cilëve vetëm 20 janë gjallë. E nënshkruar më 13 Tetor në praninë e Presidentit Trump dhe 30 liderve të tjerë ajo krijoi pritshmëri të mëdha për një proces paqeje të përhershme mes tyre dhe në rajon. Ndaj, me të drejtë kjo po vlerësohet si arritje e shënuar e Presidentit Trump, natyrisht falë mirëkuptimit dhe mbështetjes edhe nga vendet arabe, Turqia, etj.

Megjithatë, nuk ka vend për eufori mbasi ajo është vetëm marrëveshje armëpushimi dhe askush nuk e di sa do të mbajë. Sigurisht janë bërë hapa përpara, por megjithatë mbetet shumë për t'u bërë. Duhet të çarmatoset Hamasi, çka është më e lehtë në të thënë se në të bënë, të largohet nga skena politike, të rindërtohet Gaza, të reformohet Autoriteti Palestinez dhe të krijohet shteti i Palestinës. Këto janë hapa të vështirë por të domosdoshëm.

2.

Duhet zgjidhja me dy shtete! Marrëveshja e datës 8 Tetor jo



Takim i shumëpritur pas disa deklaratave të forta të Presidentit Trump dhe zhgënjimit të tij me sjelljen e Presidentit rus Putin. Ai kishte pohuar se Ukraina mund ta fitonte luftën brenda disa javëve, se Rusia është “tigër prej letre” dhe deri te mundësia e livrimit të raketave “Tomahawk” me avantazhe të mëdha luftarake për Ukrainën.



vetëm nuk e përjashtoi njohjen e shtetit palestinez, por e përfshin atë edhe pse në mënyrë indirekte si hapi përfundimtar procesit paqebërës në Lindjen e Mesme. Është pozitive se ka një bindje të përgjithshme edhe te administrata amerikane se pa njohjen e

shtetit palestinez, në paqe dhe harmoni me atë izraelit nuk mund të ketë paqe të vërtetë. Padyshim këtu Franca, Britania e Madhe, Kanadaja dhe shumë vende të tjera luajtën rolin e tyre me njohjen zyrtare të Palestinës gjatë Samitit Franko-Saudit të organizuar më 22 Shtator në selinë e OKB-së në Nju Jork.

Përvoja e 80 viteve të fundit, me shumë demarshe dhe marrëveshje paqeje e dëshmon qartë këtë realitet.

3.

Fundi i politikës amerikane me zik-zake? Kjo pyetje po shtrohet pas takimit të 17 Tetorit në Shtëpinë e Bardhë midis Presidentit Trump dhe homologut ukrainas, Zelenski. Takim i shumëpritur pas disa deklaratave të forta të Presidentit Trump dhe zhgënjimit të tij me sjelljen e Presidentit rus Putin. Ai kishte pohuar se Ukraina mund ta fitonte luftën brenda disa javëve, se Rusia

është ” tigrë prej letre” dhe deri te mundësia e livrimit të raketave ” Tomahawk” me avantazhe të mëdha luftarake për Ukrainën. Mirëpo, telefonata 120 minutëshe një ditë përpara takimit të tyre Trump – Putin, propozimi i këtij të fundit për ndërtimin e një tuneli që të lidhë Siberinë me Alaskën me emrin Trump – Putin e ndryshuan tërësisht situatën para takimit Trump – Zelenski. Pohimet e Trump për një bisedë produktive me Putinin dhe besimi se do t’i jepej fund luftës gjatë takimit të tyre në Budapest në dy javët e ardhëshme shuan shpresat për ndonjë rezultat të mundshëm me Zelenskin. Dhe kështu ndodhi. Pati lëvdata nga Trump për kostumin e Zelenskit, komplimenta si burrë i fortë, për ushtrinë ukrainase dhe luftën e saj, por vetëm aq. Mirëpo, kur erdhi fjala të tema kryesore, dërgimi i raketave Tomahawk, Trump e refuzoi sepse Amerika i do vetë dhe se Ukraina nuk do t’i përdorë, mbasi shumë shpejt sipas tij do të realizohet armëpushimi me Rusinë. Madje, Trump kërkoi që lufta të ndërpritet aty ku trupat ruse ndodhen tani, me të cilën Europa është dakord, por jo Putin.

Për pasojë, Budapesti do të ishte vijim i Alaskës në dëm të sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës, duke u kthyer sërish te versionet e mëparshme për ndarjen e Ukrainas me JO-të e njohura: Jo në NATO, JO me ushtri, Jo në territoret e pushtuara nga rusi më 2014 dhe me jo të tjera.

Nëse në Lindjen e Mesme Trump ka patur sukses me diplomacinë e forcës dhe detyrimit, me Rusinë ai deri tani ka ndjekur diplomacinë zbutëse, qetësuese dhe përkëdhelëse. Ja pse, shanset për një paqe të vërtetë në Ukrainë ishin shuar. Bëhej fjalë thjesht



për përfundimin e luftës, por me kushte, pasoja dhe kosto të përballueshme për Ukrainën dhe paqen e vërtetë atje.

Në këto kushte, Budapesti nuk do ta kënaqte Trumpin, i cili duket se e ka kuptuar që Putini po luan me atë dhe me kohën. Ndaj, me të drejtë ai e anuloi Budapestin, duke shtuar tani së fundi se nuk do ta takojë Putinin nëse ky i fundit nuk ulet për një marrëveshje paqeje. Gjithashtu, Trump vendosi sanksione ndaj 2 kompanive gjigande ruse me pasoja serioze për Moskën.

Gjithsesi, duke patur parasysh politikën e tij të deritanishme plot zik zake, duhet ende të presim e të shohim nëse Trump do të jetë konsequent ndaj Rusisë dhe do të bashkëpunojë me aleatët europianë.

4.

19 sanksione, Anti-dronë dhe pavarësi ekonomike: Në Samitin e saj më 23 – 24 Tetor në Bruksel, BE-ja miratoi tre vendime jetike për mbrojtjen e saj, mbështetjes së Ukrainës dhe pavarësisë ekonomike nga metalet e rralla kineze. Ajo miratoi Paketën e 19-të të sanksioneve kundër Rusisë, të cilat së bashku me sanksionet më të fundit amerikane ndaj dy kompanive gjigande ruse të naftës, do ta godasin Moskën mu në zemër

të ekonomisë dhe financimit të makinerisë së saj të luftës.

Vendimi i dytë lidhet me miratimin e projektit për ndërtimin brenda vitit 2027 të Murit gjigand Anti-Dronë, për t’i bërë ballë sulmeve të mundshme dhe masive me dronë nga Rusia në të ardhmen. Kjo pas disa incidenteve dhe ndëhyrjeve në hapësirat ajrore të disa vendeve anëtare të BE-së dhe të NATO-s. Ky projekt me vlerë disa miliarda Euro do të forcojë më tej kapacitetet e BE-së tashmë edhe si një Bashkim i Madh Mbrojtës. Ndërkohë, BE-ja po përgatit dhe së shpirti do të verë në zbatim një plan të ngjashëm për kompensimin e importit të metaleve të rralla nga Kina, të cilat janë jetike për ekonominë, teknologjinë dhe mbrojtjen e BE-së. kjo përballë një Kine që pritet të ashpësojë konkurrencën e saj ekonomike dhe tregtare në fushën e metaleve të rralla, ku ajo zotëron 75 për qind të rezervave botërore. Gjithashtu, Europa po kërkon mundësi dhe tregje të reja në vende të tjera. Kjo do të ndihmojë vendet anëtare të BE-së që të ulin ndjeshëm varësinë e tyre ekonomike nga Kina në këtë fushë jetike; shënojmë se Plenumi i KQ të PPK-së më 20 – 24 tetor orientoi që Kina ta shfrytëzojë këtë varësi të Europës si avantazh të saj strategjik.

BE disburson 100 milionë euro për Shqipërinë në kuadër të Planit të Rritjes të BE-së

Shqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm në zbatimin e Agjendës së saj të Reformave dhe Rritjes sipas Planit të Rritjes së BE-së, duke përbushur 21 nga 41 masat e planifikuara të reformës (51%) nga dhjetori 2024 deri në qershor 2025.

Kjo ka bërë që Komisioni Evropian të disbursojë 99,3 milionë euro në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje, duke e bërë Shqipërinë zbatuesen më të mirë në rajon për këtë periudhë raportimi.

Pagesa, e cila u njoftua nga presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen gjatë vizitës së saj në Tiranë javën e kaluar, dëshmon se Shqipëria ka zbatuar reforma të qëndrueshme strukturore në fusha kyçe si energjia, digjitalizimi, konkurrueshmëria, zhvillimi i qëndrueshëm dhe integrimi ekonomik.

Fondet do të mbështesin përpjekjet e Shqipërisë për të nxitur më tej rritjen ekonomike dhe për të forcuar institucionet publike.

Konkretisht: 46,2 milionë euro janë dhënë si hua e kredituar drejtpërdrejt në Thesar për zbatimin e reformave dhe 54,1 milionë euro (përbërë nga 28,5 milionë euro në grante dhe 24,6 milionë euro në kredi) kanalizohen përmes Kornizës së BE-së për Investime në Ballkanin Perëndimor (WBIF) për të mbështetur projektet e zhvillimit të infrastrukturës.

“Plani i Rritjes i BE-së për Ballkanin Perëndimor po jep rezultate në Shqipëri. Vendi po bën përparim të qëndrueshëm përmes Agjendës së Reformave dhe Rritjes



dhe BE-ja po përgjigjet në të njëjtën mënyrë. Ky disbursim i ri prej 100 milionë eurosh përputhet me hapat që ka ndërmarrë Shqipëria për të çuar përpara reformat që sjellin përfitime të prekshme për qytetarët e saj. Nisma të tjera të Planit të Rritjes po japin gjithashtu rezultate: sistemi bankar i Shqipërisë ka miratuar standardet SEPA, duke ulur kostot e transaksioneve për qytetarët, ndërsa vitin e ardhshëm do të përfundojmë instalimet falas Wi-Fi në të gjitha bashkitë dhe do të eliminojmë tarifat roaming mes BE-së dhe Shqipërisë”, tha ambasadori i BE-së në Shqipëri, Silvio Gonzato.

“Rezultatet e para të Instrumentit për Reforma dhe Rritje përfaqësojnë një tregues të rëndësishëm se si mekanizmi i ri i BE-së po zbatohet në praktikë në Shqipëri. Ato demonstrojnë forcimin e kapaciteteve të planifikimit, raportimit dhe zbatimit, rritjen e transparencës institucionale dhe efikasitetin e bashkëpunimit mes institucioneve shqiptare dhe Komisionit Evropian – të gjithë elementë thelbësorë të rrugës së

Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE”, tha Eridana Cano, Koordinatorë Kombëtare e Instrumentit për Reforma dhe Rritje në Shqipëri.

Instrumenti për Reforma dhe Rritje funksionon me një cikël raportimi gjashtëmuor. Shqipëria do ta paraqesë raportin e saj të ardhshëm në fillim të vitit 2026, duke ofruar prova të reformave të zbatuara mes qershorit dhe dhjetorit 2025. Komisioni Evropian do të vlerësojë më pas progresin dhe masat e arritura plotësisht do të merren në konsideratë për disbursimin e ardhshëm në kuadër të Instrumentit, planifikuar për pranverën e vitit të ardhshëm.

Rreth Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor

Plani i Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor është një nismë e ndërmarrë nga Komisioni Evropian në vitin 2023 për të përshejtuar konvergencën ekonomike të rajonit me Bashkimin Evropian dhe për t’u sjellë qytetarëve përfitimet e integritimit evropian edhe para anëtarësimit.

Ai kombinon stimujt e reformave me mbështetje financiare deri në 6 miliardë euro për rajonin dhe deri në 1 miliardë euro për Shqipërinë për periudhën 2024–2027.

Plani mbështet integrimin gradual të ekonomive të Ballkanit Perëndimor në Tregun e Përbashkët të BE-së dhe siguron fonde përmes Instrumentit për Reforma dhe Rritje, bazuar në progresin e partnerëve në zbatimin e reformave të miratuara në fusha të tilla si tranzicioni i energjisë, digjitalizimi, sundimi i ligjit, konkurrueshmëria dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor.

Zgjedhjet lokale në Maqedoninë e Veriut: Kush fitoi?

Partia në pushtet, VM-RO-DPMNE, shpalli fitore bindëse pas rundit të parë të zgjedhjeve lokale në Maqedoninë e Veriut, më 19 tetor.

Partia do të ketë kryetarë komunash në 30 nga gjithsej 80 komuna, dhe pret që në rundin e dytë të fitojë edhe në rreth 20 të tjera, përfshirë edhe qytetin e Shkupit, ku kandidati i saj, Orce Gjorgjievski, është në epërsi të madhe. “Premtuam fitore, kemi fitore”, deklaroi kryeministri dhe lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski.

Ai tha se është i kënaqur, pasi numri i përgjithshëm i votave të fituara është më i madh se në zgjedhjet parlamentare dhe ato lokale të mëparshme.

Mickoski gjithashtu konfirmoi se nuk ka ndërmend të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, pavarësisht insistimit të opozitës nga BDI, dhe theksoi se “politikat e etnocentrizmit janë mposhtur.”

Opozitarja LSDM pësoi edhe një humbje pas zgjedhjeve të vitit të kaluar – atyre parlamentare dhe presidenciale.

Megjithatë, partia vlerësoi se rezultati nuk është i keq, pasi këtë herë ka fituar më shumë vota në disa komuna dhe theksoi se ka pasur “shkelje të shumta” gjatë procesit të votimit.

LSDM do të ketë kryetarë komunash në Kriva Pallankë, Bogdanc dhe Krivogashtan, ndërsa pret të kalojë në rundin e dytë në rreth njëzet komuna të tjera.

“Kjo është dëshmi për konsolidimin brenda partisë që ka filluar dhe do ta vazhdojmë,” deklaroi lideri i LSDM-së, Venko Filipçe, i cili tha se nuk ka ndërmend të japë dorëheqje pas



këtyre rezultateve zgjedhore.

VLEN fitoi në Çair dhe Tetovë, ndërsa BDI në Gostivar

Në bllokun politik shqiptar, kandidati i VLEN, Izet Mexhiti, fitoi bindshëm në komunën kuç – Çair, ndërsa Bilal Kasami në Tetovë. Në rundin e parë, koalicioni fitoi edhe në katër komuna të tjera.

